



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË  
KOMUNË SË JUNIKUT PËR VITIN 2019**

**Prishtinë, gusht 2020**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Junikut, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga udhëheqësi i ekipit Muhamet Balaj dhe anëtarit Arben Hundozi, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Luljeta Morina.


## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore .....	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	7
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	21
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja .....	26
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	29

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i komunës së Junikut për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



### Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore janë përgatitur sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik (SNKSP).

Komuna e Junikut ka vendosur një sistem të menaxhimit financiar dhe kontrollit por që ende nevojiten veprime shtesë për të përmirësuar menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve. Në fushën e të hyrave duhet të shtohen kontrollet në kalkulimin e faturave për taksa paguesit. Ndërsa në fushën e shpenzimeve në po thuajse të gjitha kategoritë nevojiten veprime shtesë, përfshirë llogaritë e arkëtueshme, detyrimet si dhe pasuritë.

Sa i përket zbatimit të rekomandimeve Komuna kishte arritur nivel të mirë të zbatimit të tyre, ku nga dymbëdhjetë rekomandimet e dhëna në raportin e vitit 2018, nëntë rekomandime janë zbatuar, një është në proces dhe dy nuk janë zbatuar ende.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm<sup>1</sup>

#### Opinion i pamodifikuar

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

### Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. ZKA vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

<sup>1</sup> Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

## Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

---

# 1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të komunës së Junikut për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

## **Opinion i pamodifikuar**

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## **Baza për opinion**

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

## **Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të**

Kryetari i Komunës së Junikut është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

---

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalesjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## **2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli**

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

## Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Junikut kishte shpenzuar 96% të buxheti final për vitin 2019 që paraqet realizim të kënaqshëm në nivel të përgjithshëm.

Komuna e Junikut ka vendosur një sistem të menaxhimit financiar dhe kontrollit por që ende nevojiten veprime shtesë për të përmirësuar menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve. Në fushën e të hyrave dobësi ishte kalkulimi i pa saktë i faturave lidhur me taksen e densitetit dhe ndryshimin e destinimit të tokës, dërgimi me vonesë i vendimeve tek tatimpaguesit e tatimit në pronë.

Ndërsa në fushën e shpenzimeve dobësi kishte në dokumentimin e kërkesave lidhur me pushimin pa pagesë, mos rishpallja e konkursit në mungesë të tre kandidatëve në fushën e arsimit, nuk ishin zhvilluar procedura të thjeshtëzuara të rekrutimit për marrëveshjet për shërbimet e veçanta, anashkalimi i procedurave të prokurimit, dobësi në pozicionet e çmimeve për njësi, mosplotësimi i kërkesave sipas kritereve në njoftimin për kontratë. Përmirësime nevojiten edhe fushën e pasurisë tek azhurnimi i regjistrit kapital dhe mos kalkulimi të zhvlerësimit për pasurinë jokapitale, në llogarinë e arkëtueshme dhe të detyrimeve. Po ashtu, edhe dhënia e rekomandimeve jo adekuate nga auditimi i brendshëm.

### 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2019 Realizimi	Realizimit në % 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>1,784,765</b>	<b>1,957,935</b>	<b>1,883,773</b>	<b>96%</b>	<b>2,082,278</b>	<b>1,754,304</b>
Granti i Qeverisë - Buxheti	1,656,606	1,656,606	1,631,395	98%	1,974,583	1,534,867
Të bartura nga viti paraprak <sup>3</sup>	-	87,612	87,612	100%	17,407	17,697
Të hyrat vetjake <sup>4</sup>	113,557	138,344	91,862	66%	60,851	89,483
Donacionet e brendshme	-	17	-	-	-	20,900
Donacionet e jashtme	-	75,356	72,904	97%	29,437	91,357
Financim nga huamarrja	14,602	-	-	-	-	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 173,171€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave vetjake, të hyrave të bartura, donacioneve të brendshme dhe të jashtme.

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>3</sup> Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.



Në vitin 2019, komuna ka shpenzuar 96% të buxhetit final ose 1,883,773€, me një zvogëlim prej 1% krahasuar me vitin 2018. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	2019 Realizimi %	2018 Realizimi	2017 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>1,784,765</b>	<b>1,957,935</b>	<b>1,883,773</b>	96%	<b>2,082,278</b>	<b>1,754,304</b>
Pagat dhe Mëditjet	1,127,723	1,128,221	1,110,999	98%	1,085,806	1,054,758
Mallrat dhe Shërbimet	172,899	172,323	170,608	99%	177,073	184,416
Shërbimet komunale	36,200	36,200	29,910	83%	33,005	29,476
Subvencionet dhe Transferet	30,500	30,500	30,500	100%	15,600	6,050
Investimet Kapitale	417,443	590,691	541,756	92%	770,794	479,604

Ekziston një performancë e mirë sa i përket realizimit të buxhetit në nivel të përgjithshëm dhe sipas kategorive ekonomike të Komunës së Junikut.

### 2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Junikut në 2019 ishin në vlerë 179,473<sup>5</sup>€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, leje ndërtimore, taksa administrative, nga participimet, nga ushtrimi i veprimtarisë dhe nga shitja e pasurisë etj.

**Tabela 3. Të hyrat(në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	2019 Pranimet në %	2018 Pranimet	2017 Pranimet	Buxheti fillestar
Të hyrat	113,557	138,344	179,816	130%	119,108	122,377	113,557
<b>Totali</b>	<b>113,557</b>	<b>138,344</b>	<b>179,816</b>	<b>130%</b>	<b>119,108</b>	<b>122,377</b>	<b>113,557</b>

Realizimi më i lartë se sa planifikimi dhe realizimi i vitit të kaluar është rezultat i rritjes së inkasimit të tatimit në pronë, shitjes së pasurive komunale, të hyrave nga lejet e ndërtimit, taksave për ushtrimin e veprimtarisë dhe taksës për regjistrimin e trashëgimisë - ndryshimin e pronarit.

<sup>5</sup> Në kuadër të kësaj shume nuk janë të përfshira të hyrat nga gjobat në trafik në vlerë prej 7,085€.

**Çështja A1 - Vonesa në përcjelljen e vendimit për shqyrtimin e ankesave tek tatimpaguesit**

**Gjetja** Neni 31 pika 6 të Ligjit 06L/055 për Tatimin në pronën e paluajtshme përcakton që - "Komuna merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda gjashtëdhjetë ditëve nga pranimi i ankesës. Komuna mund të zgjasë, deri në tridhjetë ditë kalendarike, afatin për shqyrtimin e ankesës së dorëzuar me një vendim të arsyetuar", dhe pika 7 shpjegon se "Komuna i dërgon personit vendimin brenda pesë (5) ditëve pune pas datës së marrjes së vendimit".

Në komunë janë pranuar 17 ankesa të qytetarëve lidhur me pasaktësinë e faturave të tatimit në pronë të cilat janë shqyrtuar me kohë dhe janë dorëzuar tek pala.

Ne testuam katër prej tyre, dhe në të gjitha rastet konstatuam vonesa<sup>6</sup> në dërgimin e vendimit për shqyrtimin e ankesave tek pala ankuese. Kjo ka ndodhur si rezultat i mos kompetencës për afatet e dërgimit të vendimeve tek pala ankuese sipas kërkesave ligjore.

**Ndikimi** Dërgimi me vonesë i vendimit për shqyrtimin e ankesës, tek pala ankuese dëmton raportin ndërmjet komunës dhe qytetarëve të saj dhe ulë imazhin e komunës.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë se vendimet do të dërgohen tek palët ankuese brenda afateve ligjore.

**Çështja A2 - Kalkulim i pasaktë i të hyrave nga taksa e densitetit dhe ndryshimit të destinimit të pronës**

**Gjetja** Nga auditimi i 13 mostrave në fushën e të hyrave rezulton se:

- Sipas rregullores së komunës për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale neni 9.2 specifikon tarifën për ndryshimin e destinimit të tokës sipas klasave.

Në një faturë komuna me rastin e ndryshimit të destinimit të tokës me kërkesën e operatorit ekonomik nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore sipërfaqja prej 14,688m<sup>2</sup> e klasës 5 sipas rregullores (tokë bujqësore/ara) me tarifë 0.75€ dhe sipërfaqja prej 16,862m<sup>2</sup> e klasës 4 (tokë mal) me tarifë 1€ ka kalkuluar tarifën prej 28,867€ (në vend të 27,878€) duke e mbivlerësuar faturën prej 989€.

- Sipas UA MMPH 02/2018 për taksa administrative, leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës respektivisht shtojca

<sup>6</sup> Vonesat ishin nga 21-25 ditë përtej afatit ligjor

7 shpjegon se: Tarifa rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës caktohet në baza vjetore dhe e njëjta dërgohet në MMPH për verifikim. Pas marrjes së konfirmimit nga ana e Ministrisë duhet të ndiqen procedurat për miratim dhe publikimin e tarifës rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës sipas nenit 13 të këtij UA.

Komuna nuk e ka caktuar tarifën e densitetit në baza vjetore sipas kërkesës së UA dhe për herën e fundit që e ka caktuar atë është në kërkesën e bërë me 28.10.2016. Sipërfaqja e njësisë së re banuese është sipërfaqja neto e hapësirës së re të banimit, e dhënë e cila merret nga dokumentacioni ndërtimor i dorëzuar nga aplikuesi për leje të ndërtimit. Çdo sipërfaqe tjetër në ndërtim që nuk përdoret për banim duhet të përjashtohet. Në një rast komuna gjatë kalkulimit të faturës për leje ndërtimore dhe densitetit (B+P+7K ) me sipërfaqe bruto prej 4,013m<sup>2</sup> ka faturuar shumë prej 8,828.6€ duke mbivlerësuar faturën prej 826€.

Kjo gjendje ka ndodhur si rezultat i kujdesit jo të duhur në përcaktimin e taksës së densitetit në baza vjetore dhe kalkulimit jo të saktë të faturave.

#### **Ndikimi**

Mos caktimi i tarifës së densitetit nga viti 2016 në kundërshtim me këtë udhëzim dhe llogaritja e pasaktë e faturave paraqet shkelje ligjore dhe dëmtim të palëve përfituese gjithashtu.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të siguroj se tarifa e densitetit do të caktohet sipas kërkesave ligjore në mënyrë të përvitshme dhe se kalkulimi i faturave do të bëhet në mënyrë të saktë.

### **2.1.2 Pagat dhe mëditjet**

Buxheti final për paga dhe mëditje është 1,128,221€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit fillestar ishte 163 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 152<sup>7</sup>. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 5 zyrtarë të rinj. Kemi testuar 24 mostra për teste substanciale në vlerë 13,231€, si dhe 16 mostra për teste të pajtueshmërisë.

#### **Çështja A3 - Dobësi në procesin e dhënies së pushimeve pa pagesë**

##### **Gjetja**

Sipas nenit 15 të rregullores 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil - Pushimi pa pagesë mund të autorizohet në raste të veçanta nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit punëdhënës, si në vijim: Për ngritje profesionale të nëpunësit, për kujdesin ndaj anëtarëve të familjes për shkak të sëmundjes (specifikohen personat), për kandidim për zgjedhje, për transferim të përkohshëm në detyra tjera jashtë dhe brenda shtetit, për marrjen e detyrës së

<sup>7</sup> Ndërsa me orar të shkurtuar janë edhe 15 zyrtarë.

---

funksonarit publik dhe kryerjen e shërbimit ushtarak. Gjithashtu sipas nenit 16 të po të njëjtës rregullore specifikohet se “Kërkesa për pushim pa pagesë bëhet me shkrim, si dhe përmban qëllimin dhe periudhën e pushimit”.

Kryetari gjatë vitit 2019 kishte aprovuar pushimet pa pagesë për pesë zyrtarë me kohëzgjatje të ndryshme.

Në dy raste kërkesat e nëpunësve civil nuk përmbajnë qëllimin e kërkesës për pushimin pa pagesë gjithashtu, në njërin prej tyre vendimi është marrë një muaj me vonesë përderisa zyrtari ende pa marrë aprovimin e pushimit kishte filluar pushimin pa pagesë.

Kjo ka ndodhur si rezultat i pakujdesisë në dokumentimin e procesit të dhënies së pushimit pa pagesë.

**Ndikimi** Nëse kërkesat për pushim pa pagesë nuk përmbajnë qëllimin atëherë kjo rrezikon aprovimin e pushimit pa kriter sipas rregullores përkatëse.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë se nuk pranohet asnjë kërkesë për pushim pa pagesë, nëse në ajo kërkesë nuk përmban qëllimin e shfrytëzimit për këtë lloj të pushimit, si dhe të siguroj se zbatimi i pushimit fillon pas aprovimit të tij.

#### **Çështja A4 - Dobësi në procesin e rekrutimit**

**Gjetja** Sipas nenit 6 pika 5 e UA 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, përcaktohet që - Konkursi publik duhet të përsëritet nëse së paku tre kandidatë nuk i plotësojnë kriteret e shpallura me konkurs.

Në tri pozita në sektorin e arsimit, gjatë procesit të rekrutimit Komuna e Junikut nuk ka rishpallur konkurs meqenëse ekzistonte vetëm nga një kandidat i përgjegjshëm për secilën pozitë. Përkundër mos plotësimit të këtij kriteri Komuna kishte lidhur marrëveshje me kandidatët.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kujdesit jo të duhur nga komisioni përzgjedhës.

**Ndikimi** Nga mosrespektimi i konkurrueshmëris në procesin e rekrutimit komuna rrezikon të rekrutoj kandidat jo kualitativ.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të personelit se proceset e rekrutimit zhvillohen në pajtim të plotë me procedurat dhe rregullat e rekrutimit, dhe në rast të mungesës së tre kandidatëve të përgjegjshëm të rishpallet konkursi.

### 2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 208,524€, prej tyre ishin shpenzuar 200,518€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime kontraktuese tjera, karburant për vetura, shpenzime të telefonisë mobile, furnizim me dru, naftë për ngrohje etj. Kemi testuar 16 mostra për teste substanciale në vlerë 37,662€ si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

#### Çështja B1- Mangësi në angazhimet me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

**Gjetja** Ligji për Shërbimin Civil Nr. 03/L-149 dhe Ligji i Punës Nr. 03/L-212 i rregullojnë çështjet e angazhimeve të punonjësve me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (MSHV). Sipas nenit 12 pika 4 të ligjit, emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta (MSHV)” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Angazhimet e tilla lejohen të bëhen vetëm për punë specifike dhe në kushte të veçanta e të paparashikuara.

Gjatë vitit Komuna kishte angazhuar 11 punonjës<sup>8</sup> përmes MSHV-ve, për të cilët Komuna nuk ka zhvilluar ndonjë procedurë formale (të thjeshtësuar) të rekrutimit. Kjo ka ndodhur për shkak të kujdesit jo të duhur në respektimin e kërkesave ligjore.

**Ndikimi** Angazhimi pa procedura të thjeshtësuara rrezikon punësimin e personave jo kompetent në mungesë të konkurrenshëm.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të rritë kujdesin në procesin e angazhimit të personave me marrëveshje për shërbime të veçanta dhe angazhimet me MSHV të aplikohen vetëm për punë specifike dhe kushte të paparashikuara, gjithmonë duke i zbatuar kërkesat ligjore.

#### Çështja A5 - Mangësi në procesin e blerjes/mos zhvillim i procedurave të prokurimit

**Gjetja** Neni 4 i rregullës financiare nr.01/2013/MF për Shpenzimin e parave publike, përcakton ndër të tjera se - Prokurimi është element thelbësor për shpenzimin e parave publike, përderisa neni 21 i përcakton shpenzimet për të cilat nuk kërkohen prokurime.

Te pagesa në vlerë 200€<sup>9</sup> për “shërbime të marketingut”, kemi identifikuar se

<sup>8</sup>Mirëmbajtës i parkut, Mirëmbajtës i higjienës, Inspektor Sanitar, Shëndetësi dhe Ambient, Inspektor i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Zyrtare e prokurimit, Edukatore në Qendrën e Fëmijëve 3-5, Mësuese udhëtuese, Zyrtare Anketuese, Asistente Administrative, Zyrtare për Zhvillimin e Bizneseve dhe promovimin e turizmit, këshilltar politik.

<sup>9</sup> Shpenzimi për vitin 2019 ishte në vlerë 1,200€, marrëveshja ishte lidhur me 01.05.2019.

nuk ishin zhvilluar procedura të prokurimit për përzgjedhjen e operatorit ekonomik. Komuna ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me një operator ekonomik për afishimin e logos së komunës dhe shfrytëzimin e hapësirës së caktuar emetuese, informuese dhe reklamuese për aktivitetet e komunës në web portal. Marrëveshja ishte lidhur në kohëzgjatje prej 24 muajve, përgjatë periudhës 2019-2021, me çmim të përgjithshëm në vlerë 4,800€ dhe me çmim mujor në vlerë 200€.

Kjo ka rezultuar si pasojë e kontrolleve të brendshme jo efikase në procesin planifikimit dhe të shpenzimit të parave publike.

**Ndikimi** Mos zhvillimi i procedurave të prokurimit me rastin e përzgjedhjes së operatorit ekonomik është në kundërshtim me kornizën ligjore dhe reflekton negativisht në menaxhimin efikas të parave publike.

**Rekomandimi A5** Kryetari duhet të siguroj përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur me planifikimin dhe shpenzimin e drejtë të parave publike sipas kriterëve të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe kornizës ligjore.

## 2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 30,500€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 30,500€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me bursa për studentë, klube sportive dhe përfitues individual për nevoja shëndetësore etj. Kemi testuar 5 mostra për teste substanciale në vlerë 9,300€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

## 2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 590,691€, prej tyre ishin shpenzuar 541,756€. Ato kanë të bëjnë me mirëmbajtjen investive, ndërtesat administrative afariste, pajisje tjera, kanalizimi etj. Kemi testuar 22 mostra për teste substanciale në vlerë 479,031€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

---

### Çështja A6 - Parregullsi lidhur me çmimet për njësi në ofertën tenderuese

**Gjetja** Sipas LPP-së dhe Udhëzuesit për prokurimin publik, pika 3. Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit, përkatësisht pika 4.2.c. përcakton se gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues (AK) do të ketë obligim të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut. Po ashtu pika 10. Funkcionet e Departamentit /Njesisë së Prokurimit, përkatësisht pika 11.1.c. Zyrtari përgjegjës i prokurimit, siguron që mallrat, shërbimet dhe punët blihen në mënyrën më ekonomike, efikase dhe efektive. Gjithashtu zyrtarët e autoritetit kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave financiare të sigurohen se çmimet e njësive të kontraktuara janë konform paramasës së përlllogaritur. Dhe të merren parasysh çmimet e publikuara, nga Zyra e Statistikave të Kosovës dhe/ose çmime tjera indikative zyrtare (të tilla si

zyra tatimore, zyra e doganave, oda ekonomike, etj); dhe/ose, çmimet e tregut lokal; dhe/ose, çmimet e kontratave paraprahe të nënshkruara nga autoriteti i njëjtë apo tjetër kontraktuese; dhe/ose, çmime ndërkombëtare të publikuara; dhe/ose, çmimet për njësi të publikuara ne webfaqe të KRPP-se; etj

- Te pagesa në vlerë 69,906€, për kontratën “Ndërtimi i qendrës për Kulturë, Turizëm dhe Agrobiznes”, respektivisht situacioni i tretë i punëve të realizuara, kemi identifikuar se çmimi për pozicionin 1.3 të paramasës dhe parallogarisë së kontratës dhe situacionit të paguar, që përmban: Punimi i tabelës sinjalizuese ku duhet të përfshihen informatat: Projekti, Investitori dhe punë kryesi. Në çmim të përfshihen edhe tabelat sinjalizuese që paralajmërojnë rrezikun me mbishkrim "kantier ndërtimi". Tabela informuese duhet të jetë me dimensione 200x300cm, ndërsa tabelat e paralajmërimit duhet të jenë me dimensione 50x80cm dhe duhet të vendosen në rrethojën e punishtes, këto dy tabela janë paguar me çmim total prej 20,000€. Ndërsa për këtë projekt ishte kontraktuar një operator ekonomik që ka bërë, “Hartimin e projektit kryesor të qendrës për Kulturë, Turizëm dhe Agrobiznes”<sup>10</sup>, dhe në paramasë këtë pozicion (këto dy tabela) i kishte përlllogaritur në vlerë totale prej 700€. Ky pozicion me dy tabelat sinjalizuese ishte pjesë edhe e ekzaminimit fizik<sup>11</sup>.
- Gjithashtu te pagesa në vlerë 30,094€, për të njëjtën kontratë, respektivisht situacioni i dytë i punëve të realizuara, kemi identifikuar se çmimi për pozicionin 1.1 të paramasës dhe parallogarisë së kontratës dhe situacionit të paguar, që përmban: Përgatitja e vend punishtes, mobilizimi dhe furnizimi me makineri dhe material të nevojshëm për të filluar punimet, ishte 26,783€. Ndërsa në paramasë ky pozicion ishte përlllogaritur në vlerë 500€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mangësive të kontroleve të brendshme në procesin vlerësimit të drejtë të çmimeve të pozicioneve në kuadër të ofertës tenderuese, sipas çmimeve të përlllogaritura në paramasë.

## **Ndikimi**

Mangësitë e identifikuar lidhur me çmimet abnormalisht të larta apo/dhe të ulëta për pozicione në ofertën financiare tenderuese reflekton negativisht në vlerësimin e saktë të kostos së projektit dhe në udhëheqjen e aktiviteteve të prokurimit në harmoni me parimet e konkurrencës, efikasitetit dhe efektivitetit. Në këtë rast fondet e vëna në dispozicion të komunës nuk janë menaxhuar drejt sepse komuna ka pranuar vlerë të ulët të punëve krahas shpenzimit të parasë publike.

<sup>10</sup>Vlera e përlllogaritur e paramasës për këtë projekt nga kompania projektuese ishte 896,066€, ndërsa kontrata ishte nënshkruar në vlerë 777,777€.

<sup>11</sup> Ekzaminimi fizik ishte realizuar me datë 01.07.2020 në prezencë të menaxherit të kontratës dhe zyrtarit kryesor financiar.

---

**Rekomandimi A6** Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në procesin vlerësimit të drejtë të çmimeve të njërive në kuadër të ofertave tenderuese sipas çmimeve të përlllogaritura në paramasë, apo edhe manualeve me çmimet referente për njësi të publikuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, çmimeve të tregut dhe çmimeve tjera indikative zyrtare. Kryetari si udhëheqës i ekzekutivit të komunës duhet të siguroj mbikëqyrjen e administrimit financiar të komunës.

#### **Çështja A7 - Parregullsi lidhur me vërtetimin tatimor dhe sigurimin e ekzekutimit**

**Gjetja** Sipas LPP, nenit 65, paragrafi 4.8, Operatori ekonomik (OE) nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç kur një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë. Gjithashtu sipas Udhëzuesit për prokurimin publik, siguria e ekzekutimit të kontratës mund të kërkohej si parakusht për nënshkrim të kontratës. Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës dhe do të mbetet valide për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës. Kriteria të vendosura në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Për kontratën “Ndërtimi i aneksit në objektin e komunës”, në vlerë 124,579€, periudha e realizimit të kontratës ishte nga dt.21.06.2019-23.11.2019, kemi evidentuar se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë ishte kërkuar si kriter, vërtetimi tatimor nga Administrata Tatimore, se OE i ka kryer obligimet tatimore ose është në marrëveshje me ATK-në për shlyerjen e borxhit deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit gjithashtu edhe siguria e ekzekutimit. Përderisa gjatë ekzaminimit të dokumentacionit kemi gjetur se në vërtetimin tatimor ishte evidentuar se OE ka borxhe tatimore ose obligime tjera tatimore të pashlyera ndërsa mungonte siguria e ekzekutimit.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase me rastin e verifikimit të dokumentacionit të nevojshëm për plotësimin e kërkesave të përshtatshmërisë në dosje të tenderit dhe sigurimit të dokumentacionit të kërkuar për nënshkrimin e kontratës.

**Ndikimi** Mangësitë e identifikuar reflektojnë negativisht në zhvillimin e procedurave të prokurimit respektivisht në plotësimin e drejtë të kushteve, për pjesëmarrje dhe për lidhjen e kontratës dhe në zbatimin e kontratës sipas kriterëve kontraktuale.

**Rekomandimi A7** Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur plotësimin e drejtë të kushteve për pjesëmarrje dhe kriterëve të kërkuara me rastin e nënshkrimit të kontratës.



## 2.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

### Çështja A8 - Zotimi dhe urdhërblerja me vonesë

**Gjetja** LMFPF, Neni 36.1 dhe Rregulla financiare për shpenzimin e parave publike Nr.01/2013/MF, Neni 17 pika 1.5 përcakton se zotimi i mjeteve duhet të bëhet para hyrjes në obligime kontraktuale gjithashtu urdhërblerja të krijohet dhe përgatitet nga ana e organizatës buxhetore, pas zgjedhjes së ofertuesit me të cilin është nënshkruar kontrata.

Në katër raste në investime kapitale dhe pesë raste në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve zotimi i mjeteve dhe procedimi i urdhërblërjeve ishte bërë me vonesë përkatësisht pas datës së faturave<sup>12</sup>. Kjo ka ndodh si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase në procesin e menaxhimit dhe ekzekutimit të pagesave.

**Ndikimi** Zotimi i mjeteve financiare dhe procedimi i urdhërblërjeve me vonesë vështirëson zbatimin e drejtë të kontratave dhe krijon paqartësi rreth urdhërësive për furnizim, shërbime apo fillim të punëve.

**Rekomandimi A8** Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet në harmoni me proceduarat e përcaktuara me LMFPF dhe rregullat financiare për shpenzimin e parave publike.

## 2.2 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 3,499,091€, pasurive jokatitale është 49,679€, ndërsa komuna nuk ka stoqe. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 9 milion, si dhe 100 mostra për teste të pajtueshmërisë.

### Çështja C1 - Mangësi në regjistrat e pasurisë

**Gjetja** Sipas rregullores për menaxhimin e pasurisë jofinanciare 03/2013 neni 6 çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive

<sup>12</sup> Në investime kapitale te pagesat: Ndërtimi i rrugëve lokale në vlerë 2,478€, Mirëmbajtja investive në vlerë 26,000€ dhe 20,000€, Ndërtimi i shtëpizës bjeshkatore alpine në vlerë 19,395€. Në Mallra dhe Shërbime te pagesat: Shërbime tjera kontraktuese në vlerë 1,493€ dhe 1,313€, Naftë për ngrohje qendrore në vlerë (1,833€ x 2) dhe Hartimi i projektit të qendrës për kulturë, turizëm, agrobiznes në vlerë 3,510€.

---

jofinanciare që i ka në menaxhim të saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Sipas nenit 22 pika 1 - zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtvizore. Nga 100 mostrat e testuara është konstatuar se:

- Komisioni i vlerësimit ka vlerësuar 287 parcela/prona të komunës prej të cilave 279 nuk janë regjistruar në regjistrin e pasurisë kapitale dhe sipas komisionit të vlerësimit kanë vlerën prej 11,124,231€.
- Komuna ka shitur 10 vetura me ankand publik të cilat ishin jashtë përdorimit por të cilat figurojnë ende në regjistrin e pasurive kapitale me vlerë të përgjithshme neto në libra prej 4,267€.
- Në sistemin e-pasuria nuk është bërë llogaritja e shpenzimeve të zhvlerësimit dhe zhvlerësimit të akumuluar për pasurinë jokapitale.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i kujdesit jo të duhur të zyrtarës së pasurisë për azhurnimin e regjistrit të pasurive kapitale si dhe mirëmbajtjes së dobët të sistemit e-pasuria.

**Ndikimi** Mos azhurnimi i regjistrit kapital dhe mungesa e llogaritjes së zhvlerësimit për pasurinë jokapitale keq informon përdoruesit e pasqyrave financiare.

**Rekomandimi C1** Kryetari duhet të siguroj përmes zyrtarës së pasurisë azhurnimin e regjistrave të pasurisë kapitale dhe përlllogaritjen e zhvlerësimit për pasurinë jokapitale.

## 2.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 186,498€. Kjo vlerë përbehet nga të hyrat e pa arkëtuara të tatimit në pronë, taksave për ushtrimin e veprimtarisë dhe të hyrat e pa arkëtuara nga qiraja.

## Çështja A9 - Dobësi në procesin e faturimit në taksën për ushtrimin e veprimtarisë shërbime ndërtuese (ndërtime të larta)

**Gjetja** Sipas rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, neni 6, paragrafi 6.1 nën paragrafi 1.6 është e përcaktuar taksa për ushtrimin e veprimtarisë në biznes për subjektet që kryejnë vetëm shërbime ndërtuese (ndërtime të larta) në vlerë prej 250€.

Në dy nga pesë mostrat e testuara në kategorinë e taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste, komuna kishte faturuar nga 150€ (në vend të 250€) pra nga 100€ më pak sesa taksa e përcaktuar me rregullore. Pas identifikimit nga auditori, komuna ka nxjerr aktvendimet me dt.03.08.2020 ku ka bërë korrigjimin e tarifës.

Kjo gjendje ka ndodhur si rezultat i mungesë së kontrollit dhe pakujdesisë në procesin e faturimit.

**Ndikimi** Faturimi i pa saktë dëmton buxhetin e komunës duke rezultuar me më pak fonde nga këto raste.

**Rekomandimi A9** Kryetari duhet të siguroj se procesi i kontrollit në kalkulimin dhe faturimin e taksave është funksionale duke zvogëluar mundësinë gabimeve dhe zbatuar korrigjimet për rastet e identifikuar.

## 2.4 Detyrimet

### 2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2019, ishte 35,635€<sup>13</sup>. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Detyrimet e papaguara kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e automjeteve, shpenzimet e telefonit, ujit dhe rrymës, derivate të naftës dhe shpenzime të tjera të ndryshme.

## Çështja B2 - Vonesë në pagesën e detyrimeve

**Gjetja** Sipas LMFP, Neni 39, dhe Rregullës financiare për shpenzimin e parave publike, organizata buxhetore është përgjegjëse për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Nga testimet rezulton se dy fatura në vlerë 20,359€ nuk ishin paguar brenda afatit kohor të përcaktuar, vonesat ishin një dhe katër muaj vonesë. Vonesat në

<sup>13</sup> Kjo shumë është prezantuar nga entiteti i audituar.

pagesë ishin rezultat i mungesës së mjeteve financiare për shkak të hyrjes në obligime pa u siguruar fondet e nevojshme.

**Ndikimi** Vonesat në pagesën e obligimeve rrisin rrezikun për kosto shtesë buxhetore në rast të padive nga kreditorët për mos përmbushje me kohë të detyrimit për pagesë.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet pas sigurimit të mjeteve financiare, gjithashtu duhet të siguroj respektimin e kriterëve ligjore për realizimin pagesave brenda afatit të përcaktuar kohor.

## 2.4.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019, ishte 35,169€ shumë kjo e prezantuar për një rast të pretendimit për kompensim të pagave.

## 2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Detyrimet kontraktuale sipas evidencës së komunës janë në vlerë 757,551€ detyrime të cilat i takojnë kontratave të nënshkruara në vitin 2019.

## 2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

NJAB – ka një auditor i cili është edhe drejtor i saj i cili ka kryer pesë auditimet e planifikuara duke dhënë 48 rekomandime prej të cilave 17 janë zbatuar, 15 janë në proces dhe 16 janë të pazbatuara. Me një proporcion të mbulueshmërisë së periudhës prej 34% në vitin 2019 dhe 66% për vitin 2018. Kryesisht janë auditime të pajtueshmërisë dhe komuna ka themeluar komitetin e Auditimit i cili ka mbajtur katër takime në vitin 2019. NJAB posedon planin vjetor dhe strategjik dhe i ka mbuluar fushat me rrezik.

### Çështja A10 – Dobësi në Auditimin e brendshëm

**Gjetja** Sipas doracakut të auditimit të brendshëm pjesa II<sup>14</sup> faqe 77 dhe 78 të gjeturat janë deklarime të fakteve. Vetëm ato të gjetura të cilat janë të nevojshme për të mbështetur apo për të parandaluar keqkuptimet e konkluzioneve apo rekomandimeve të auditorit duhet të përfshihen në komunikimet finale të auditimit. Të gjeturat dhe rekomandimet duhet të bazohen në karakteristikat e mëposhtme: Kriteri, gjendja, shkaku, ndikimi dhe mbi bazën e tyre jepet rekomandimi.

Nga analiza e raporteve të auditimit të brendshëm nga 48 rekomandimet e dhëna nga NJAB, nëntë prej tyre nuk plotësojnë karakteristikat e të gjeturës për

<sup>14</sup> I botuar nga Ministria e Financave respektivisht nga Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm.

arsye se nuk ka ndonjë mos përputhje ndërmjet kriterit se si duhet të jetë dhe gjendjes faktike prandaj edhe dhënia e rekomandimeve nuk është relevante<sup>15</sup>.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i kujdesit jo të duhur nga ana e udhëheqësit të auditimit të brendshëm.

**Ndikimi** Dhënia e rekomandimeve aty ku nuk ka mos përputhje ndërmjet asaj se si duhet të jetë dhe gjendjes faktike nuk ndihmon përmirësimin e sistemeve në komunë. Kjo e bënë auditimin joefikas.

**Rekomandimi A10** Kryetari duhet të sigurohet nëpërmes komitetet të auditimit se NJAB ofron raporte cilësore ku verifikohen dobësisë ekzistuese dhe ofrohen rekomandime të vlefshëm për pajtueshmëri, përmirësimin e kontrolleve dhe menaxhimin sa më të mirë të parasë publike.

### 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të Komunës së Junikut ka rezultuar në 12 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Komuna ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve me 13.03.2020 sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, nëntë rekomandime janë zbatuar, një është në proces dhe dy nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

---

<sup>15</sup> P.sh Në raportin –“Auditimi i zyrës së tatimit në pronë” - AB tek e [gjetura 3.1.5](#) thekson: - “Kemi gjetur se ka barazime të rregullta mujore për vitin 2018 dhe 2019 në mes të zyrtarëve përgjegjës dhe zyrtarit për të hyrat vetanake të komunës. Barazimet janë të rregullta mujore dhe vjetore ashtu siç kërkohet me rregulloren e thesarit”. Ndërsa tek [rekomandimi 3.2.5 AB](#) thekson: - “Rekomandojmë drejtorin për buxhet dhe financa dhe zyrtarët përgjegjës që të vazhdoj me barazime të rregullta me zyrtarin e të hyrave. Barazimet e rregullta mes zyrtarëve për të hyrat vetanake dhe operatorës për futjen e të dhënave është një praktikë e mirë në mënyrë që të hyrat e inkasuara të identifikohen dhe verifikohen sa më mirë”.

Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PVF	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes si dhe të marrë veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe për ta konfirmuar menaxhimin, evidentimin dhe raportimin e saktë të pasurisë. Duhet të vazhdohet në zbatimin e rekomandimeve të bëra gjatë auditimeve paraprake sipas planit të veprimit si dhe nevojitet përmirësim në përpilimin e planit vjetor të prokurimit, gjegjësisht planifikimi më i mirë i prokurimit është i nevojshëm. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme.	Nuk janë ndërmarrë veprime në përmirësimin e gjendjes në azhurnimin e regjistrit të pasurisë kapitale dhe kalkulimit të zhvlerësimit në pasurinë jokapitale. Por janë bërë përmirësime në plotësinë e regjistrit kapitale.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
2	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurohet se të hyrat regjistrohen me kohë në SIMFK në mënyrë që analizat dhe raportimet të mbështeten në informata të sakta.	Janë ndërmarrë veprime dhe këtë vit nuk kemi vërejtur raste të këtilla.	Rekomandim i zbatuar.
3	Paga dhe mëditje	Kryetari duhet të sigurojë se aktivitetet e rekrutimit zhvillohen në pajtim me procedurat dhe rregulloret relevante të cilat sigurojnë trajtim të barabartë për të gjithë konkurrentët potencial.	Janë ndërmarrë veprime prandaj në vitin aktual nuk janë gjetur raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
4	Mallra dhe shërbime	Kryetari duhet të sigurojë se marrëveshjet për shërbime të veçanta lidhen pas zhvillimit të procedurave të thjeshtësuara të rekrutimit dhe vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike si dhe ato të realizohen brenda afatit kohor të përcaktuar me kornizën ligjore.	Nuk janë ndërmarrë veprime edhe në vitin 2019 gjendja është e njëjtë.	Rekomandim i pazbatuar.

5	Subvencion e dhe transfere	Kryetari duhet të sigurojë se rregullorja për subvencion zbatohet duke përcjellë të gjitha procedurat përkatëse, deri te miratimi i tyre. Për më shumë Kryetari duhet të sigurohet që përcjellën procedurat edhe për monitorim dhe raportim sipas rregullores në fuqi.	Janë ndërmarrë veprime prandaj në vitin aktual nuk janë gjetur raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
6	Investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që personat profesional të ofruar nga operatori gjatë procesit të ofertimit duhet të jenë të angazhuar për punë për të cilën edhe janë kërkuar nga komuna. Mbikëqyrësi i caktuar nga komuna duhet të sigurojë që personat e tillë janë angazhuar në realizimin e projektit. Në rastin kur operatori ekonomik duhet zëvendësuar këta persona, atëherë paraprakisht ata duhet të jenë të aprovuar nga komuna, në mënyrë që të sigurohet që operatori ekonomik ka profesionalizëm të duhur në realizimin e projektit.	Janë ndërmarrë veprime prandaj në vitin aktual nuk janë gjetur raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
7	Investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se kontrollet janë efektive në zbatimin e proceduarve të prokurimit dhe menaxhimin e kontratave si dhe të aplikoj masa për ndarje të duhur të detyrave në përputhje me kornizën e aplikueshme ligjore.	Janë ndërmarrë veprime prandaj në vitin aktual nuk janë gjetur raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
8	Investime kapitale	Kryetari duhet të sigurohet që komisioni i vlerësimit duhet të bëjë vlerësimin e ofertave saktësisht sipas kërkesave të paraqitura në dosje të tenderit. Kryetari po ashtu duhet të sigurohet që secili projekt i përfunduar ka të kryer pranimin teknik.	Janë ndërmarrë veprime prandaj në vitin aktual nuk janë gjetur raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
9	Pasuria jofinanciare kapitale	Komuna, situacionet e realizuara duhet të regjistroj në SMKF si investime në vijim. Pastaj me përfundim të projektit, duhet të bëhet kërkesa në thesar që situacionet e regjistruara të hiqen dhe pastaj të kapitalizohet i tërë projekti si i përfunduar në SMKF.	Janë ndërmarrë veprime të pjesërishme.	Rekomandim i zbatuar.

10	Pasuria jofinanciare jokapitale	Kryetari duhet të sigurohet që lista e gjeneruar nga e-pasuria është e plotë dhe prezanton saktësisht vlerën e pasurive nën 1,000€ të cilën komuna e ka në pronësi. Po ashtu kryetari duhet të sigurohet që personi përgjegjës për menaxhim të pasurive ka nivelin e duhur të njohurive dhe raporton saktësisht vlerën e pasurive në PFV.	Janë ndërmarrë veprime të pjesërishme megjithatë kalkulimi i zhvlerësimit në pasurinë jokapitale nuk është bërë.	Rekomandim i zbatuar.
11	Detyrimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në menaxhimin e obligimeve ndaj kontraktuesve. Hyrja në obligime të bëhet vetëm nëse paraprakisht janë zotuar mjetet e mjaftueshme financiare. Obligimet të paguhen brenda afatit kohor prej 30 ditëve nga data e pranimit të faturave. Po ashtu të gjinden zgjidhje për shlyerje të obligimeve të cilat datojnë nga viti 2014.	Nuk janë ndërmarr veprime edhe në vitin 2019 gjendja është e njëjtë.	Rekomandim i pazbatuar.
12	NJAB	Kryetari duhet të sigurojë që rekomandimet e auditimit të brendshëm zbatohen në tërësi si dhe komiteti i auditimit është vazhdimisht funksional.	Komuna ka ndërmarr veprime në themelimin e komitetit të auditimit.	Rekomandim i zbatuar.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se vendimet do të dërgohen tek palët ankuese brenda afateve ligjore.		
2	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se tarifa e densitetit do të caktohet sipas kërkesave ligjore në mënyrë të përvitshme dhe se kalkulimi i faturave do të bëhet në mënyrë të saktë.		
3	Paga dhe mëditje	Kryetari duhet të sigurojë se nuk pranohet asnjë kërkesë për pushim pa pagesë, nëse në ajo kërkesë nuk përmban qëllimin e shfrytëzimit për këtë lloj të pushimit, si dhe të sigurojë se zbatimi i pushimit fillon pas aprovimit të tij.		
4	Paga dhe mëditje	Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të personelit se proceset e rekrutimit zhvillohen në pajtim të plotë me procedurat dhe rregullat e rekrutimit, dhe në rast të mungesës së tre kandidatëve të përgjegjshëm të rishpallet konkursi.		
5	Mallra dhe shërbime	Kryetari duhet të rritë kujdesin në procesin e angazhimit të personave me marrëveshje për shërbime të veçanta dhe angazhimet me MSHV të aplikohen vetëm për punë specifike dhe kushte të paparashikuara, gjithmonë duke i zbatuar kërkesat ligjore.		



6	Mallra dhe shërbime	Kryetari duhet të siguroj përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur me planifikimin dhe shpenzimin e drejtë të parave publike sipas kritereve të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe kornizës ligjore.
7	Investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në procesin vlerësimit të drejtë të çmimeve të njërive në kuadër të ofertave tenderuese sipas çmimeve të përlllogaritura në paramasë, apo edhe manualeve me çmimet referente për njësi të publikuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, çmimeve të tregut dhe çmimeve tjera indikative zyrtare. Kryetari si udhëheqës i ekzekutivit të komunës duhet të siguroj mbikëqyrjen e administrimit financiar të komunës.
8	Investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur plotësimin e drejtë të kushteve për pjesëmarrje dhe kritereve të kërkuara me rastin e nënshkrimit të kontratës.
9	Çështjet e përbashkëta	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet në harmoni me procedurat e përcaktuara me LMFPP dhe rregullat financiare për shpenzimin e parave publike.
10	Pasuria jofinanciare	Kryetari duhet të siguroj përmes zyrtares së pasurisë azhurnimin e regjistrave të pasurisë kapitale dhe përlllogaritjen e zhvlerësimit për pasurinë jokapitale.
11	Të Arkëtuesh met	Kryetari duhet të siguroj se procesi i kontrollit në kalkulimin dhe faturimin e taksave është funksionale duke zvogëluar mundësinë gabimeve dhe zbatuar korrigjimet për rastet e identifikuar.
12	Detyrimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet pas sigurimit të mjeteve financiare, gjithashtu duhet të siguroj respektimin e kritereve ligjore për realizimin pagesave brenda afatit të përcaktuar kohor.
13	Funksioni i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të sigurohet nëpërmes komitetet të auditimit se NJAB ofron raporte cilësore ku verifikohen dobësisë ekzistuese dhe ofrohen rekomandime të vlefshëm për pajtueshmëri, përmirësimin e kontrolleve dhe menaxhimin sa më të mirë të parasë publike.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

*Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit*

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

*Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Letër konfirmimi



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

**Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së **Junikut**, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

**z. Agron Kuci**  
Kryetar i Komunës së Junikut

Data: 06.08.2020, Junik,